

VENDIM
Nr. 113/2017

PËR NGRITJEN E NËNKOMISIONIT TË PËRHERSHËM PARLAMENTAR
“PËR BARAZINË GJINORE DHE PARANDALIMIN E DHUNËS NDAJ GRUAS”

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës dhe të neneve 19 e 55 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Pranë Komisionit të përhershëm për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë ngrihet nënkomisioni i përhershëm “Për barazinë gjinore dhe parandalimin e dhunës ndaj gruas”.

II. Objekti i veprimtarisë së këtij nënkomisioni është:

- a) ndërmarrja e hapave të nevojshëm për adresimin e dhunës ndaj grave dhe vajzave;
- b) gjetja e mekanizmave efikasë për para-ndalimin dhe reduktimin e dhunës në familje;
- c) propozimi i ndërhyrjeve ligjore të nevojshme që ndihmojnë në përmirësimin e mbrojtjes së grave dhe vajzave dhe rritjes së sigurisë së jetës së tyre;
- d) mbikëqyrja parlamentare e institucioneve përgjegjëse për trajtimin e rasteve të dhunës në familje, përmbushja prej tyre e të gjitha detyrimeve ligjore, zbatimi i masave për parandalimin e dhunës ndaj grave dhe vajzave dhe fuqizimi social dhe ekonomik i tyre.

III. Nënkomisioni përbëhet nga 9 anëtarë. Kryetari i takon shumicës parlamentare dhe zëvendëskryetari pakicës parlamentare. Përbërja e nënkomisionit miratohet me vendim të Kuvendit.

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 4.12.2017